

VINCENZO BELMONTE

VJERSHE

STRIHAR

I *Vjershe* riflettono l'ambiente di Strihar (S. Cosmo Albanese), piccolo comune della provincia di Cosenza, dove lentamente declina la tradizione culturale arbëreshe.

L'idea della morte ritorna ossessionante, simbolo e ricapitolazione di un mondo amaro, falso, minacciato dal crollo imminente. Ma la consapevolezza della vanità del finito avvia alla ricerca interiore, alla scoperta di un nuovo orizzonte in cui le contraddizioni si risolvono e la morte stessa si trasfigura.

Per quanto attiene alla lingua, se il punto di partenza è la parlata attuale di Strihar, si assiste tuttavia al progressivo recupero di termini desueti, *ha pax legomena* e accezioni rare che danno vita a un originale esperimento di restauro linguistico.

La parola suggestiva, amorosamente ricercata nel ricco patrimonio della tradizione colta e popolare, svolge una funzione insostituibile nella struttura armonica del componimento poetico e palpita di nostalgia per l'Arbëri, patria ideale collocata in un mitico tempo remoto.

Mark Minshi

VDEKJA E TRIMOSHIT

Kur gjëni kurmin tim
të vdekur e pa frymë,
ja qellni mëmes sime të shkretë,
mëmes së mjerës që më pret.

T'i shprishinjtë lule e lotë,
me lule një dorë pjetë
e lotë për kurmin të gjakësuar,
për gjellen që fati i zi më muar.

Qamëni, trima e kopile,
qamëni, lule e bilbile,
se ylli i jetës sime u shua
dhe bashkë me ju s'ë dritë për mua.

29.10.1970

LA MORTE DEL GIOVANE EROE

Quando troverete il mio corpo
morto, senza respiro,
portatelo alla mia povera madre,
alla misera madre che mi aspetta.

Perché vi sparga sopra lacrime e fiori,
fiori a piene mani
e lacrime per il mio corpo insanguinato,
per la vita che il destino mi ha rapito.

Piangetemi, giovani e fanciulle,
piangetemi, fiori e usignoli,
ché la stella del viver mio s'è spenta
e con voi non c'è per me più luce.

29.10.1970

KANGJELI I TË VDEKURVET

Gjegjni, vëllezer, vuxhen tonë
çë ju thërret ka vendi i thellë,
ka vendi i thellë pa dritë
ku rrinë të vdekurit.

Bota, bota na mbulon
e gryken tonë mbullin.
Po gjegjni e vën'ji re
kësaj fjalë së qetë e të le.

Ndëse rûni si u bëmë
nëng mund të na njihni më.
Ky dhe se ç'është i rremë!
Ashtu si jini qemë.

Shkûm për udhat tûj dhe na
dhe vjershe malli këndûm.
Te Ghalji mûrtim hjenë,
te Ghalji mbjûm rrogjenë.

Mbjana kurmi na u mbi
sa të tundej zëmra u lodh.
Te goja fryma u ftua,
ra nata, dita u shua.

IL CANTO DEI MORTI

Ascoltate, fratelli, la nostra voce
che vi chiama dal luogo profondo,
dal luogo profondo tenebroso
dove abitano i morti.

La terra, la terra ci ricopre
e ci chiude la bocca.
Ma ascoltate attentamente
questa parola tacita e leggera.

Se vedete come siamo ridotti
non ci riconoscete più.
Quanto è falso il mondo!
Come voi siete fummo.

Passammo anche noi per le vostre vie
e cantammo versi d'amore.
Alla fontana riposammo,
alla fontana riempimmo gli orciuoli.

Subito si intorpidì il corpo
non appena il cuore si stancò di battere.
In gola si raffreddò il respiro,
cadde la notte, il giorno si spense.

S'panë më sytë kur dheu na u err,
për të sprasmen herë na qëlloi
e çë kishim qënë harrûm
kur ramë te i madhi gjum.

Gjella te një momend u humb,
mbrënd' mjegulles u mbyt.
E, ndëse ti e penxon,
qe një ënderr jeta jonë.

Kush qe i nëmur, kush qe i bëgat,
kush rroi, kush vdiq çë ish djal.
Shurbiset çë jeta ndan
janë gjithë të përzier ndë këtë anë.

Bukuri, si lula u veshk!
Trimëria sa na nganoi!
Si gjithëmi gjithë nën dhe,
grua pjake dhe grua e re!

U piks te këta varre të erret
një natë e zezë mbi ne.
Ngë këndonjen zogj këtu nën,
vet' hardhëla na gjën.

Non videro più gli occhi quando il mondo si oscurò,
ci addormentammo per l'ultima volta
e, cadendo nel gran sonno,
dimenticammo ciò che eravamo stati.

La vita scomparve in un momento,
annegò nella nebbia.
E, a ben considerare,
fu sogno l'esistenza.

Chi fu povero, chi ricco,
chi visse a lungo, chi morì bambino.
Ciò che la vita separa
è tutto qui rimescolato.

Bellezza, come appassì il tuo fiore!
Quanto ci ingannò la giovinezza!
Siamo tutti simili sotterra,
giovani e vecchi!

In queste oscure tombe si è addensata
una nera notte su di noi.
Non cantano uccelli quaggiù,
solo la lucertola ci visita.

Milingonat hëngëtin trutë,
ndë krye na bënë folenë.
Këtu krymbi bëri shpinë
e ditë e natë gërryn.

Shiu na ngrin, vapa na than,
me motin misht u kalb
e dalë e dalë u shpua
ky kurm e u bë buhua.

Këtu ë katundi i bënë për ju.
Ju presmi: moti shkon.
Ju presmi te kjo errësi,
të hûj edhe gjiri.

Parë sa të nisëni hjimes poshtë,
për ne të nëmurit
të lidhur filaqi
buthtoni lipisi.

Parkalesni pa pushim.
Na dhëftë shpëtim Ynzot.
Na bëftë një jetë të re.
Paftë lipisi për ne.

4. 2. 1975

Le formiche hanno divorato il cervello,
nei nostri teschi si annidano.
Qui il verme ha la sua dimora
e giorno e notte rode.

La pioggia ci gela, il caldo ci dissecca,
col tempo si è putrefatta la carne
e man mano si è bucato
il nostro corpo ed è diventato polvere.

Qui è il paese preparato per voi.
Vi attendiamo: il tempo passa.
Vi attendiamo in queste tenebre,
estranei e familiari.

Prima di avviarvi per la china,
per noi miseri
prigionieri in un carcere
mostrate pietà.

Pregate senza posa.
Ci salvi il Signore.
Ci dia una vita nuova.
Abbia pietà di noi.

4. 2. 1975

ÇË PARË SE SA TË BIE

Çë parë se sa të bie te gryka e sëmburkut
çë parë se sa të bie për mua kumbora
më duket se të tërë jeten e bora,
se jam i vatë.

E thërritem vetë u bjerrafat
kur rûnj aprapa me çë fërtunë
njeri pas tjetrit vjetet shkûn
tridhjetë e dy.

Fati pa ëmer, fati i zi,
i dorrokopsi tërkuzallet,
vetëhenë më rrazbisi ka të gjallet,
te hjea m'e shtiti.

Haretë, hjidhitë çë zëmra ndîti
u bënë mërzhim e mot i bjerrë.

Hiri tas dielli, qiella u err,
mbi dhe m'u ngrys.

Ni çë drita u spav, ni çë gjella u zvis,
bë të shoh, Luçilje, kado gjënde,
gazin e zjarmë të syvet tënde,
gazin e zjarmë.

4. 5. 1977

ANCOR PRIMA CHE IO CADA

Ancor prima che io cada nella bocca del sepolcro,
ancor prima che suoni per me la campana,
mi pare d'aver perduto la vita intera,
d'essere finito.

E mi chiamo infelice
quando considero con che fortuna
l'uno dopo l'altro sono passati
i miei trentadue anni.

Il destino ignoto, il destino funesto,
ha travolto le danze intrecciate,
dai viventi ha allontanato la mia vita,
nell'ombra l'ha sospinta.

Le gioie, i dolori che il cuore sentì
sono ormai noia e tempo perduto.
Il sole è tramontato, s'è oscurato il cielo,
la notte mi ha sorpreso.

Ora che la luce è fuggita e la vita si è disfatta,
fa' che io veda, Lucilla, dovunque tu sia,
la gioia ardente dei tuoi occhi,
la gioia ardente.

4. 5. 1977

DEGË DIMRI

Degë dimri, degë e xheshur,
ka tëtimi e ngjerthëlluar,
sa mbrënda të fryn një avull
i ngrohtë, ka gjiri i mbjuar
gjella mburon e hjeshe,
me fjutura e lulëzuar.

18. 1. 1979

TE PRËHRI I GJELLES

N'ujë të ëmbel,
n'ujë të ngrohtë,
te prëhri i gjelles
pushuam ëndrra dëfrimi.
N'ujëra na reshten moti
të ngrita, të farmëkosta,
dhe paprëjtur na shtie
suvala për shkretime.

Shkrehen xhixhat
e shuhen.

1. 2. 1979

RAMO INVERNALE

Ramo invernale, ramo spoglio,
intirizzito dal freddo,
non appena un caldo vapore
ti alita dentro, dal seno
ricolmo sgorga la vita e ti adorni,
fiorito di farfalle.

18. 1. 1979

NEL GREMBO DELLA VITA

In acqua
calda dolce,
nel grembo della vita,
riposammo sogni di piacere.
Il tempo in acque ci allontana
fredde amare
ed incessantemente ci sospinge
l'onda per i deserti.
Sprizzano le scintille
e si spengono.

1. 2. 1979

UDHA E GJËRAVET

Udha e gjëravet - një.
Të shumet i fjandaksen padija.
Shkel përandaj ndieme të padëlgueshme
dhe lotë - dishërime të dështuara.
Atë çë s'qe mos ndjek me ëndrra të kota.
S'ish të mundshem, ndëse s'streksi.

24. 4. 1979

LATHE BIOSAS

Jeta,
si rremë e fshehur,
flluhet
me frushull të ëmbel.

1. 5. 1979

YEJ

Mas, hipu, zdrepu, viru,
yej yemjen tënde të rraken
monofille, merimagë,
ndori se vrundullera fryn.

6. 5. 1979

LA VIA DELLA REALTA'

Una - la via della realtà.
Le molte - fantasie dell'ignoranza.
Calpesta pertanto sentimenti irrazionali
e lacrime - desideri abortiti.
Ciò che non è stato non inseguirlo con vani sogni.
Non era possibile, se non è accaduto.

24. 4. 1979

LATHE BIOSAS

La vita,
ascoso rivolo,
scorre
con dolce murmure.

1. 5. 1979

TESSI

Sospenditi, misura, sali, scendi,
tessi, ragno, la tela
sottile trasparente,
quantunque infuri la tempesta.

6. 5. 1979

LISI I MALLIT

Mos këput degen e blerë!

Një lagësirë gufon
e qelbosur, e zezë.

Rrënjat mos i gërmo!

Qesnjen jargë të helmtë
krymbat tue brufulluar.

15. 5. 1979

TELQ

Telq
ka shtrydhoret e heshtjes
lëng
urtërije së hidhëruar.

16. 5. 1979

TE MOTI I BUTË

Te moti i butë
më marrtë e bushtra gogë,
kur fjutura
në shpi më siell pranverën.

25. 5. 1979

L'ALBERO DELL'AMORE

Non spezzare il ramo verde!

Un umore si distilla
nauseabondo, nero.

Non scalzare le radici!

Emettono bava velenosa
i vermi brulicando.

15. 5. 1979

TRAGGO

Traggo
dai torchi del silenzio
succo
di sapienza amara.

16. 5. 1979

NELLA MITE STAGIONE

Nella mite stagione
mi prenda la morte crudele,
quando la farfalla
mi porta in casa la primavera.

25. 5. 1979

NJË GËRMË

Gjah gjëmë ka gryka ime
një gërmë dragunartë,
zë i afraindem etërash
brez pas brezi të vuvur,
ka tërkuza të angosur e mjerimit.
I vrullet një ajer
më daltë ka goja, shqerrtë
faqet historiye së rremë, shqerrtë
stolitë e bulbra të gënjimit, lisat
e gëlthetë zdradhakopstë.
Buja u bëfsha e gjykimit.

2. 6. 1979

NË XHAVIDHEN

Kur nata librazbyth i jep fushtagave
ujëra për me shtërfrundur,
në xhavidhen dëgjonj grahmen e dejtut,
andidherash, përzier.

2. 8. 1979

UN GRIDO

Come tuono dalla mia bocca
un grido risuoni,
voce terribile di padri
muti d'età in età,
soffocati dal capestro della miseria.
Impetuoso un vento
esca dalla mia gola, strappi
le pagine di storia bugiarda, strappi
i ricchi ornamenti dell'inganno, gli alberi
disseccati disvella.
Che io divenga la tromba del giudizio.

2. 6. 1979

NELLA CONCHIGLIA

Quando a furie la notte dà potere
di sconvolgere le acque,
nella conchiglia ascolto il fragore del mare,
di lontano, confuso.

2. 8. 1979

LIMISHTË

Ndërron gjëndja e yjvet,
drejtimi i puhjisë, shpejtësia e remevet.
Na pushomi, limishte,
te një krah i vdekur i lumit të historisë.

20. 8. 1979

KURRË !

Kur zjarri çë na losen
do të ngrëhet frungullerë?
Një ditë e bardhë
kur mund të jetë se na puthen
me të paren rrëmbë e diellit?
Kapton ëndrra ndonjëherë
prakun e drites?

30. 8. 1979

FUSCELLI

Muta la posizione delle stelle,
la direzione del vento, la velocità delle correnti.
Noi riposiamo, fuscilli,
in un'ansa morta del fiume della storia.

20. 8. 1979

MAI !

Il fuoco che ci consuma
quando si leverà in una fiammata?
Un giorno felice
quando ci bacerà
con il primo raggio di sole?
Varca il sogno talvolta
la soglia della luce?

30. 8. 1979

PAS NEVE

"Pas neve një brez do të bihet
fatbardhë. Pas neve..."

Ka rrënjat tona të krymbura, të shterpuara,
mos pritni pemë, mos pritni villostar.

14. 9. 1979

LOGJIKË

Rrumb është ka të njëjtat kafsha
të nxjerrsh rrjedhime të ndrysha.

Po edhe më jeta më llaven
kur kafsha jetërson pa ndërruar rrjedhime.

1. 11. 1979

NAKATOSJE

Mbi kotësinë e gjithësisë nëng shkruajta vëllime
as mbajta ligjërata. Ka dritora,
i gërdhitur, mbal luzmes volla zorrat
dhe vetem më shpëlqeu se s'mbyta dheun.

3. 11. 1979

DOPO DI NOI

"Dopo di noi progenie
felice nascerà. Dopo di noi..."

Dalle nostre radici bacate, inaridite,
non attendete rampollo né frutto.

14. 9. 1979

LOGICA

Dalle stesse condizioni è assurdo trarre
conseguenze diverse.

Però ancor più la vita mi dissenna,
mutando condizioni, serbando conseguenze.

1. 11. 1979

NAUSEA

Non tenni dispute né scrissi volumi
sulla vanità dell'universo. Nauseato,
dalla finestra rigettai sulla folla e mi dispiacque
solo che il mondo non ne fu sommerso.

3. 11. 1979

MOTI

Moti yt, moti im,
i njëjti, ç'ëndëtim
me hundime, me dre,
me tuptime, me ambni.
Pa mos një gjasme.

11. 11. 1979

N' HIVURIN

Kur, ngjyrat tue braktisur, mbrënde
n' hivurin e vetëhesë sate,
errësires mos ju zmeks. Ke syrin
hilnar.

30. 11. 1979

IL TEMPO

Il tuo tempo, il mio tempo,
l'identico, che abbiamo intessuto
di affanni, di paure,
di palpiti, di serenità.
Diverso da ogni altro.

11. 11. 1979

NELL'ANTRO

Allorché, abbandonando i colori,
ti addentri nell'antro del tuo essere,
non temere l'oscurità. Lucerna
è l'occhio.

30. 11. 1979

FLLUROMË

Xien për avsin e irem
ture ëndërrur pushimin
e hanosura izë.
Surropulli i llaftarmë
grundë-fjaturam pas peles
hingëllin: gëthonjen thundrat.
Shpirtin tim kallaver
hje të athuna lumësije
pa mëshirë fortëlosnjen.
Fatin vuan e lëvizjes
çdo send i dalë ka gjiri
i shterpë i asgjësisë
për me kapur fani
gonovare, të mbrazta:
pather lula e gëlirës
pështron gjëmbin e zisë.
Ti për udha të ndrysha,
i mallepsur, na helq.
Në Tyj steksen nga zeks,
në Tyj, pat i çdo beri.

INNO

Ruota per l'oscuro abisso
sognando la quiete
l'astro fulgente.
Il destriero anelante
con la criniera al vento insegue la cavalla
nitrendo: risuonano gli zoccoli.
Vane ombre di felicità
il mio spirito errante
dilaniano spietate.
Soggiace al moto fatalmente
ogni essere uscito dal seno
infecondo del nulla
per afferrare apparenze
effimere, vacue:
sempre il fiore dell'appagamento
nasconde la spina del desiderio.
Tu per vie diverse,
amato, ci attrai.
In Te termina ogni brama,
in Te, bersaglio di ogni freccia.

Qën'ja jote ë hyjnore,
e tutjeme. Njësohet
me Tyj vetem kush djeg
të përlyemet në zjarrin
e vullnetes së dashme,
vetem kush në ujanen
e këshillit tënd mbytet.
Ëmë Ti syrin e amshuam
të vështronj si gëlitet
në mua mose ngallima
e së panjohures psorë,
të vështronj se si feksen
në të kalbtat rronia,
në çdo gjë ftyra jote.
Gërma e vrerit u kthjelltë
në jonësinë e gjithësisë.
Ahjt në mua frymen tënde.
Ëmë të pështjellem me fllagë.
Asgjësomë të bëhem dritë.

18. 12. 1979

La tua essenza è divina,
inaccessibile. Si identifica
con Te solo chi brucia
le impurità nel fuoco
della volontà amabile,
solo chi nell'oceano
del tuo consiglio sprofonda.
Dammi l'occhio eterno
perché veda crescere
di continuo in me il seme
dell'ignoto destino,
perché veda trasparire
nella putredine la vita,
in ogni cosa il tuo volto.
Il grido di dolore si purifichi
nell'armonia dell'universo.
Alita in me il tuo spirito.
Avvolgimi di fiamma.
Annientami perché divenga luce.

18. 12. 1979

NËPËR KËRRA E KARKOZHA

Nëpër kërra e karkozha
ditësh të bjerra rrebeshi
nduhta breng'je së angosur
pruftë, ehona të rruzhesë.

Ehjen griha e mënizes
grëthe të bushter, krafoset
yemja e thellme, gërvishtet
zdrama e plirë ç'asi moti.

Më gjon ende mbi duben
druza, të gjarat e dashta
vrëhen, unë i kafosur
shkas në gremet e nates.

13. 3. 1980

ATTRAVERSO LANDE ARIDE E STERILI

Attraverso lande aride e sterili
di giorni perduti porti il vento
messaggi d'angosciato dolore,
echi della tempesta.

Affila la cote del ricordo
lame crudeli, trafitto
è il tessuto profondo, lacerata
la ferita sanguinante da quel tempo.

Mi annuncia presagi sulla cima
la civetta, le amate sembianze
si offuscano, io tormentato
scivolo negli abissi della notte.

13. 3. 1980

XHINAGË

Bir, si m'u bijte,
ftyra demore e hënes të magjipsi.
Vivilen ahjti i mjegulluar t'e zbardhi,
të shkrëfëndoi nekujen
e gjelles briri i saj,
të bëri xhinagë.

27. 3. 1980

LARVATUS PRODEO

Katundith filaqi,
kukule e xejes,
çerë shkarrafune,
shpagar i gramsuar.
Dhe mbrënda një vravashkë
më fren veksinë.

14. 4. 1980

ORCIUOLO ROTTO

Figlio, appena sbocciasti,
il volto taurino della luna ti stregò.
L'alito nebbioso ti gelò il respiro,
ti perforò il vaso
della vita il suo corno,
ti ridusse a orciuolo rotto.

27. 3. 1980

LARVATUS PRODEO

Paese carcere,
bozzolo della routine,
volto mascherato,
mantello logoro.
E, dentro, una fiaccola
mi allietta l'estasi.

14. 4. 1980

PSE?

Pse gërmon mose
gërmadhet e pëllasit të gremisur
dhe ëmer standon të patrashgueshem,
tue ngjallur, atë, jonësi të bjerra n'eren?

7. 5. 1980

SERPOSI

Një erë hyjnore më shtëfrosi
drej amulvet të siles.
Qe serposi gazmend.
Moter, pap bjegun.

16. 6. 1980

PERCHE'?

Perché continui a scavare
tra i ruderi del palazzo demolito
e acquisti fama non ereditabile,
ridestando, padre, armonie perse nell'aria?

7. 5. 1980

LA FINE

Un vento divino mi rapì
verso le fonti della luce.
La mia fine fu gioia.
Cessa il pianto, sorella.

16. 6. 1980

DIKU

As era na reroi as rema.
Para lundres u aull
njëza e fanem, u spav.
Diku lundromi.

13. 10. 1980

AB ASSUETIS

Mixhë e vërzingëri
vëzhgonj me mlezë të steret,
dëgjonj me mënd të bëmtë. Ab assuetis
non fit passio.

1. 11. 1980

MAGISTRA

Titullin mjeshterlje,
Histori, ç'e bën,
ndëse kurset e tu
askush i pasen?

2. 11. 1980

CHISSA' DOVE

Né il vento ci ingannò né la corrente.
Davanti alla barca evaporò
l'isola fatata, sparì.
Navighiamo chissà dove.

13. 10. 1980

AB ASSUETIS

Innocenza e depravazione
osservo con palpebra ferma,
ascolto con mente indifferente. Ab assuetis
non fit passio.

1. 11. 1980

MAGISTRA

Che te ne fai, Storia,
del titolo di maestra,
se nessuno
segue i tuoi corsi?

2. 11. 1980

I SHPENGUAR SKOLLADHEFER

Krua të pashtershem, dejt, diell
thom atë çë këputi
zinxhiren çë me lypsje hatë qersingë
angosen. Hyj
e thom ndëse, i shpenguar
skolladhefer, n'vetëminë
e hapësires hajdhepsen.

10. 11. 1980

TE GOLLJA

Verbësirë
te gollja
apo dritë
të fshehur.

23. 11 1980

DREHJIMISËT

Mos na anangasni,
të vdekur, mos na nisni.
Katundi
drej juve drehjimiset.

23. 11. 1980

AQUILA SVINCOLATA

Fontana inesauribile, mare, sole
chiamo colui che ha spezzato
la catena che con mancanza bisogno necessità
soffoca. Dio
lo chiamo se, aquila
svincolata, nella solitudine
dello spazio gode.

10. 11. 1980

NELLA CAVERNA

Cecità
nella caverna
o luce
nascosta.

23. 11. 1980

PRECIPITA

Non forzateci,
morti, non trascinateci.
Il paese
verso di voi precipita.

23. 11. 1980

GJAKMARRJA GJENIKE

Në kopshtat e cangëluar të Babilonisë
për drita të luatshme dhe çutullaz jermoni
pa gjegjur klithmat ka të erret pate nën
ku njerëzimin farkosni
n'ujth për rrënjat e dhrivet.
në lëng dehës ëmbëlor.
Juve, çë, të pështjellë
në nishanen gënjeshterl
e të bardhit, trushqeni, as drangunora
as dregje ju prëçmonj. Gjakmarrja
e gjatë gjenike të gjarat
gavnare do të dhifisinj
je askush me zogja të larta do të vajtonj
Perëndinë Perëndimore të perënduar.

1. 3. 1981

LA VENDETTA GENICA

Nei giardini pensili di Babilonia
delirate per luci mobili e cetre e non udite
le grida dagli oscuri piani inferiori
dove l'umanità macerate
in linfa per le radici delle viti,
in dolce succo inebriante.
A voi, che, avvolti
nell'ingannevole bandiera
del candore, commettete sacrilegio, né tempeste
né dragoni io predico . Lenta,
la vendetta genica le orgogliose sembianze
farà svanire
e nessuno con alti lamenti piangerà
l'Impero d'Occidente tramontato.

1. 3. 1981

SHTOJCË — APPENDICE

KANGJELI I KOLLOVEQIT

Kolloveq, oj Kolloveq,
pse mua më qeve kaq i keqë?
Ngë ishim llarghu më se një meter,
u ka një anë, ajo ka një jeter.
Gjithë një herje u ngre e pa fjarë
ngrëjti vithtë si një pullar.
Kur pa fjarë u ngre e m'u nis
te trutë gozhda hiri e u stis.
Kur të pe çë iknje, mall i parë,
një lotë te hunda m'u kalllar.
Çë kur u humbe ndë atë xhirun
jam si qeni pa patrun,
si forxhari pa fngjil,
si llinterna pa fitil,

jam si derku pa koritë,
jam si kau çë i nxurtin britë,
jam si ghrasta çë nëng ka lule,
jam si kopshti pa marrule.
Kur u humbe më ra zalia,
u mbullitin sytë e mia,
më trandaksi zëmra e u ftua,
m'u ça një asht e m'u ça një thua,
m'u kalllar qumshtit te gjuri,
doj të zbatirnja kryet te muri.
Mos ngë më mbajin Dany e Ndini
dreq dreq menu mua ish e më vini.
Mos ngë më mbajin Ndini e Dany
kisha vatë te katanani.
Thûmë, o vashez, se pse të bora!
Mos fillari qe se ngë nxora

u marmagen ka govëra?
Thûmë, o vashez, se çë të bëra!
Mos fillari ngë të pëlqeu
pse te gëlpëra nëng hin peu?
U ngë mund të di çë të vate shtrëmbur,
u ngë mund të di ku mund të ka dhëmbur.
U di vet' se më lëreve e ike
si mixore edhe si armike.
U di vet' se qëndrova i vrarë
kur këtje ruanja pa të parë.
U di vet' se qëndrova i vjerrë
kur m'u duk se të kisha bjerrë.
U di vet' se nëng di më
ndë jam i zgjuar o jam e fjë.
Kolloveq, oj Kolloveq,
pse mua më qeve kaq i keqë?

6. 5. 1974

N O T E

Una esposizione organica dei *philosophoumena* accennati nei *Vjershe* è stata presentata dall'autore in *Anceps Necessitas*, Strihar, 1976.

— XHINAGÈ / ORCIUOLO ROTTO. Un orciuolo rotto è stato rinvenuto accanto ai resti di un neonato sepolto nella grotta preistorica di Franchthi (Argolide). Cfr. Th. W. Jacobsen, *17.000 anni di preistoria greca in Viaggio nel tempo*, Le Scienze, Milano, 1977, p. 160.

La testa del toro è un antico simbolo lunare.

— MANDALA / IL MANDALA. Il màndala - figura costituita da un quadrato inscritto in un cerchio - è un simbolo italico e indiano dell'universo. Secondo Jung, disegna màndala chi ha superato i suoi contrasti intimi e sta per conquistare la propria totalità (*Ganzheit*). Cfr. C. Jung. - K. Kerényi, *Prolegomeni allo studio scientifico della mitologia*, Torino, 1972, pp. 24-30.

— KANGJELI I KOLLOVEQIT. Kolloveq: toponimo.

Stampa: Tito-linotipya GRAPHIsud - Acri (Cs)
Via Campo Sportivo, 50 - Tel. (0984) 954087